

## NDIHMA EKONOMIKE

### KUSH E PERFITON:

Sipas ligjit nr.9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" dhe VKM nr.787 datë 14.12.2005 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike" përfituesit e ndihmës ekonomike janë :

- Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
- Jetimët e papunë, mbi 25 vjeç
- Jetimët e moshës 18- 25 vjeç, të cilët nuk janë vendosur në institucionet e shërbimeve shoqërore ose nën kujdestari .
- Prindërit e femijëve të lindur trinjak e më shumë, që u përkasin familjeve në nevojë.

### DOKUMENTACIONI

1. Kryetari i familjes, që kërkon ndihmë ekonomike, duhet të paraqes, pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në bashki, ku ka vendbanimin nga data 1-15 të cdo muaji, dokumentat e mëposhtme, së bashku me kërkesën e nënshkruar nga të gjithë anëtarët madhorë të familjes:

- Deklaratën për gjendjen social-ekonomike të familjes, sipas modelit të përcaktuar, e cila plotësohet, nga kryefamiljari, një herë në vit, si dhe në rastet kur familja përfituese rikthehet në skemën e ndihmës ekonomike.
- Deklaratën tip mujore që plotësohet detyrimisht cdo muaj dhe firmoset nga të gjithë personat madhorë të familjes që aplikon për ndihmë ekonomike.
- Çertifikatën e gjendjes familjare, ku shënohet data e regjistrimit në regjistrin themeltar, vendbanimi i mëparshëm dhe ndryshime të tjera të familjes.
- Çertifikatën e pronësisë, të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.
- Aktin e marrjes në pronësi ose në përdorim të tokës (tapinë e tokës) për zonat, ku regjistrimi i pronësisë nuk ka përfunduar ende. Pas përfundimit të regjistrimit të tokës dhe për këto zona do të jetë e vlefshme certifikata e pronësisë mbi tokën sipas pikës ç.
- Vërtetimin si punëkërkuar të papunë, për të gjithë anëtarët e familjes, të aftë për punë, që aplikojnë për ndihmë ekonomike. Ky vërtetim lëshohet nga zyra e punës cdo tre muaj.

2. Familjet që kanë vendbanimin në qytet, të regjistruara në zyrat e gjendjes civile pas datës 1 gusht 1991, të cilat vendbanimin e mëparshëm e kanë patur në fshat, duhet të paraqesin, për të kërkuar ndihmë ekonomike përveç dokumentave të mësipërme dhe këto dokumenta:

- Vërtetimin e nënshkruar dhe të vëlosur nga kryetari i komunës a bashkisë (që në përbërje kanë fshatrat, banorët e të cilave janë trajtuar me tokë), nga kryetari i fshatit dhe përgjegjësi i zyrës së kadastrës, ku të thuhet se këto familje nuk disponojnë tokë në pronësi, sipas vendimit të komisionit të ndarjes së tokës, meqenëse janë larguar nga vendbanimi, para datës 1 gusht 1991, për arsye pune.
- Kopjet e librezës së punës, të noterizuara, që vërtetojnë së pjesëtarë të tyre kanë qenë të punësuar nga casti i largimit nga vendbanimi në fshat.
- Çertifikatën e pronësisë së tokës, kur kanë përfituar tokë.

3. Kur këto familje e ndryshojnë vendbanimin, ato duhet të paraqesin, brenda 30 ditëve, në vendbanimin e ri, një dokument, ku vërtetohet se kanë përfituar ndihmë ekonomike në vendbanimin e mëparshëm.

4. Jetimët që janë të papunë, përveç dokumenteve të përcaktuara më sipër duhet të paraqesin edhe kopjen e noterizuar për statusin e jetimit.

5. Familjet e invalidëve të punës, përveç dokumentave të përcaktuara më sipër duhet të paraqesin edhe kopjen e noterizuar të vërtetimit KMCAP-it.

6. Përrjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike familjet, që kanë në përbërje edhe një antar të vetëm, që plotëson kushtet e mëposhtme, i cili:

- është pronar i çdo kapitali, me përjashtim të shtëpisë së banimit dhe të tokës bujqësore.
- është ekonomikisht aktiv (punëdhënës, i punësuar ose i vetpunësuar).
- është jashtë shtetit për çdo arsye me përjashtim të personave që kryejnë studime ose janë me kurim.
- nuk është i regjistruar si punëkërkues i papunë.
- refuzon punën e ofruar nga zyra e punësimit.
- ka refuzuar të marrë tokën e dhënë sipas ligjit nr.7501.
- nuk tërheq ndihmën ekonomike brenda afatit.
- ndërmer veprime të qëllimshme për të përfituar ndihmë ekonomike
- 

#### PROCEDURA

- a. Ndihma ekonomike shpërndahet një herë në muaj me vendim të Këshillit të Njesisë të Qeverisjes Vendore.
- b. Kërkesa për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet me shkrim nga Kryetari i familjes dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët madhor të saj.
- c. Aplikantët paraqesin dokumentacionin tek administratori shoqëror pranë njesisë së pushtetit vendor.